



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I QARKUT VLORË

VENDIM

Nr. 10, Datë 28.04.2017

PËR MIRATIMIN E VENDIMEVE PËR KALIMIN NË PRONËSI TE PASURIVE TË PALUAJTSHME TË NDËRTUARA DERI ME 10.08.1991, E TË TRUALLIT FUNKSIONAL TË TYRE, KUR NUK POSEDOHEN AKTE FITIMI PRONËSIE DHE PËR REGJISTRIMIN E TYRE.

Këshilli i Qarkut Vlorë i mbledhur sot më datë 28.04.2017 në zbatim të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të VKM 608, datë 05.09.2012 "Për përcaktimin e procedurës së kalimit të pronësisë të pasurive të paluajtshme, të ndërtuara deri më 10.08.1991 e të truallit funksional të tyre, kur nuk posedohen akte fitimi pronësi, si dhe për regjistrimin e tyre" i ndryshuar, si dhe të vendimeve të dërguara nga Bashkia Sarandë.

VENDOSI :

1. Të miratojë Vendimin Nr. 1, datë 14.12.2016 "Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj" për subjektet Kërkues **Z. Kiço Mërtiri dhe Z. Lefter Mërtiri «gjeneralitetet e subjektit sipas certifikatës së vitit 1974 - 1985»** për një objekt banimi (2 Kat) me sipërfaqe ndërtimi kati përdhe 137.3 m², kati i parë 78.7 m² dhe sipërfaqe truall funksional 200 m², me vendndodhje në lagjen "Nr. 2", të qytetit të Sarandës, zona kadastrale 8641, nr. pasurie 11/362 që kufizohet nga Veriu me banesë, nga Jugu me pasurinë 11/361, nga Lindja me pasurinë nr. 11/363 dhe nga Perëndimi kufizohet me rrugën "Aleks Verli".
2. Të miratojë Vendimin Nr. 1/1, datë 14.12.2016 "Për kalimin në pronësi të pasurisë së paluajtshme të ndërtuar deri më 10.08.1991 dhe truallit funksional të saj" për subjektin Kërkues **Znj. Kasjani Beka « gjeneralitetet e subjektit sipas certifikatës së datës 10.08.1991»** për një objekt banimi (2 Kat) me sipërfaqe ndërtimi 76.5 m² Kati Përdhe, 76.5 m² Kati i Parë dhe sipërfaqe truall funksional 170 m², me vendndodhje në lagjen "Nr. 1", të qytetit të Sarandës, zona kadastrale 8641, nr. pasurie 12/109 që kufizohet nga Veriu me rrugën Qazim Demi "", nga Jugu me me pasurinë 12/310, nga Lindja me pasurinë 12/191 nga Perëndimi kufizohet me pasurinë 12/111.